



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 543/2 prot

Datë 16.03.2022

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK ANKIMUES
DHE PRETENDIMET MBI OFERTUESIT E TJERË**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Filo Gas” SHPK & “LG West Balkan” në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-19409-02-10-2022, me objekt: “Blerje Oksigjen mjekesor”, me fond limit 35 204 000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 28.02.2022 nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Shkodër.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “Messer Albagas” SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Ankimues: BOE “Filo Gas” SHPK & “LG West Balkan”
Rruga Korçë-Bilisht, Km 2, Korçë.

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Shkodër
Rruga Kole Heqimi, Shkodër

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Messer Albagas” SHPK
Autostrada Tiranë - Durrës, Km 4.5, Tiranë

Në datën 15.03.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 543 e BOE “Filo Gas” SHPK & “LG West Balkan për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-19409-02-10-2022, me objekt: “Blerje Oksigjen mjekesor”, me fond limit 35 204 000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 28.02.2022 nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Shkodër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të

paraqitur nga BOE “Filo Gas” SHPK & “LG West Balkan si dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “Messer Albagas” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyen e skualifikimit të BOE “Filo Gas” SHPK & “LG West Balkan, e cila kundërshtohet në ankesën me nr. 543 prot, datë 15.02.2022.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyeja e skualifikimit:

- 1. Operatori ekonomik Filo Gas ne formularin e vetedeklarimit ka deklaruar se ka paguar te gjitha taksat tatimet dhe sigurimet shoqerore e vertetuar kjo me vertetimin e dt.14.02.2022, ku realisht vertetimi i dates 14.02.2022 i ngarkuar ne spe tregon qe operatori ka detyrime prej 47593 leke.*
- 2. Operatori ekonomik LG West nuk ka paraqitur vertetimin e xhiros vjetore per vitin 2018 2019 2020.*
- 3. Ne lidhje me deshmitet per kontratat e ngjashme operatori ekonomik Filo Gas ka paraqitur faturat tatimore per oksigjen ku vlera totale e tyre nuk permbushen 25% e 40% te kontratave te ngjashme. Gjithashtu keto fatura nuk jane te vulosura dhe te firmosura dhe nuk jane te deklaruar ne organet tatimore sipas pikes b te 2.3.1 te kapacitetit teknik. Operatori ekonomik ka paraqitur vertetim realizimi ku vlera e kontrates eshte shprehur ne modhen denare dhe jo ne monedhen tone, si dhe nje vertetim ku vlera eshte me tvsh ku komisioni e ka te pamundur ta zhveshe nga tvsh fondin limit te nje shteti tjetet.*
- 4. Autorizimi per tregtimin e mallrave leshuar operatorit ekonomik LG West Balklan jane ne gjuhen angleze .*
- 5. Certifikate ISO 9001 e LG West eshte ne anglisht*
- 6. Certifikate iSO 450001 e LG West mungon*
- 7. Kontratat e tankerave jane pa noter.*
- 8. Operatori ekonomik Filo Gas nuk permbush kriterin 2.3.8 per kapacitetin e tankerave 5000-10000 litra.*
- 9. Ne lidhje ma piken 2.3.7 Operatoim ekonomik per tankerin me depozite 50000 litra fatura e paraqitur nuk eshte origjinale dhe kontrata e shitblerjes e panoterizuar.).*

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret të cilat BOE “Filo Gas” SHPK & “LG West Balkan, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Messer Albagas” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Messer Albagas” SHPK, të kritereve si më poshtë vijon:

Shtojca 7.

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Kapaciteti teknik

Operatori ekonomik duhet të provojë se nëse shpallet fitues, është në gjendje të sigurojë min 3 (tre) tanker me kapacitet minimumi 5000-10.000 litra per t'u instaluar në ambientet e Spitali Rajonal Shkoder. Per periudhen e zgjatjes se punimeve, kontraktori duhet te marrë masat për të mos nderprerë furnizimin me oksigjen të shërbimeve spitalore. OE ka detyrimin per certifikimin e Tankerave në Inspektoriatin Shteteror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion), rregjistrimin dhe ndjekjen e kryerjes se inspektimeve sipas afateve te percaktuara ligjore. OE duhet te provojë se siguron, ne rast avarie te tankerit te oksigjenit lëng, furnizimin me tanker rezerve ose me bombola oksigjeni mjeksor gaz, në rampat e oksigjenit të gaztë, për te siguruar gadishmerine e furnizimit me oksigjen te shërbimeve spitalore. Sasia e oksigjenit mjeksor të gaztë të konsumuar gjatë kesaj periudhe do të konvertohet në oksigjen të lëngët sipas normativave teknike.

- Ne rastin kur OE i ka në pronesi, duhet te paraqese nje deshmi per pronesine mbi keto tankera (fature blerje ose dokument doganor per importimin e tankerave te oksigjenit ose cdo lloj dokumenti tjetër ligjor i cili dëshmon disponimin në pronësi të këtyre tankerave) dhe Vertetimin e leshuar, jo me pare se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave, nga organet kompetente kombëtare për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit ne fuqi, ku të jene përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotesimi i standarteve, kushteve teknike dhe te sigurisë.
- Ne rast se tankerat e oksigjenit do te merren me qira, duhet te paraqitet kontrata ose marrveshja paraprake e qirase, shoqeruar me dokumentacionin që vërteton pronesine e pronarit te tankerave te oksigjenit si dhe Vertetimin e leshuar, jo me pare se 6 muaj nga data e hapjes se ofertave, nga organet kompetente kombëtare për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit ne fuqi, ku të jene përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotesimi i standarteve, kushteve teknike dhe te sigurisë.

Shenim: Gjatë periudhës nga nenshkrimi i kontrates deri në instalimin e tankerave, Operatori i suksesshem duhet të furnizojë AK perfitues me bombola oksigjeni mjeksor te gazte i cili do te konvertohet me sasine e Oksigjeni mjeksor të lëngët. Oksigjeni mjeksor gaz i përdorur në bombola duhet të jetë i regjistruar sipas pikës 2.3.3.Për përmbushjen e kësaj pike OE duhet te kete në pronësi ose me qera minimumi 50 bombola oksygeni mjekësor i gazet e vërtetuar kjo me dokumentacionin përkatës vërtetim nga ISHTI dhe certifikata e komformitetit te bombolave qe disponon.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST ku te specifikohen pikat e mësipërme. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet në rastin kur operatori shpallet fitues ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Gjithashtu nga ankimuesi kërkohet të verifikohet nëse cmimi përputhet me dispozitat e VKM 645, dt 01.10.2012 dhe deklarinimin e cmimit të origjinës

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 16.03.2022.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri